



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**SQARIM MBI DOKUMENTAT E TENDERIT Nr. 3**

Referuar kërkesës për informacion të dërguar nga operatore të interesuar, si edhe bazuar në pikën 6.1 dhe pikën 17.1, të VKM-së nr. 1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, Njësia e Hartimit të Dokumentave të Tenderit, sqaron të interesuarit si më poshtë:

**Pyetje për sqarim:**

Lidhur me përcaktimin në dokument:

***Deklarata bankare të lëshuara nga një ose më shumë banka***

*Referenca-Dokumenti i tenderit, kreu II, tek kërkesat e përgjithshme për kualifikim, pika (2)/2.1/g/I.*

*“Ofertuesi duhet të vërtetojë se zotëron kapacitete ekonomike e financiare për të përmbushur detyrimet e Autorizimit Individual, me anë të:*

***I. Deklaratave bankare të lëshuara nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare të ofertuesit, të cilat garantojnë përmbushjen nga ana e ofertuesit të detyrimeve që rrjedhin nga marrja e Autorizimit Individual sipas deklarimeve të Shtojca 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 14, por jo më pak se:***

- 1. Për 1 (një) të drejtë përdorimi 80 MHz: 3,624,000 Euro (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e katër mijë Euro).*
- 2. Për 1 (një) të drejtë përdorimi 40 MHz: 1,812,000 Euro (një milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë Euro).*

*Në rast se ofertuesi do të paraqesë disa oferta, deklarata bankare duhet të përfshijë shumatoren e çmimit të të gjitha ofertave së bashku.*

*Në rast të mosrealizimit të këtij kushti, ofertuesi nuk kualifikohet.”*

Konkretisht, varësisht nevojave që secila shoqëri ka për këtë bandë frekuencash dhe përcaktimeve mbi mënyrën e zhvillimit të tenderit raund pas raundi, një operator mund të paraqesë ofertën e tij në të pesë raundet për të mundësuar blerjen e sasisë së synuar. Referuar përcaktimit në dokument te hijezuar me lart duket se në deklaratën bankare, operatori duhet të garantojë shifrën e të pesë

ofertave qe operatori do te depozitohet përpara hapjes se procedurës së tenderit, eventualisht për të pesë raundet, gjë që është jo e arsyeshme kur në fakt formulari i çmimit të ofertës mund të plotësohet në momentet e fundit përpara afatit të depozitimit të Ofertave dhe nuk do ishte e mundur që Operatori të sigurojë nga bankat brenda ditës “*shumatoren e çmimit të të gjitha ofertave se bashku*”, shtuar këtu edhe rrethana ku pas sqarimeve nga AKEP, ofertuesi mundet edhe të tërhiqet nga ndonjë raund/raundet në vijim.

Ndaj dhe, duke konsideruar edhe praktiken në proceset e kaluara të tenderave të zhvilluar nga AKEP, kuptojmë se deklarata bankare do duhet të plotësohet për shumën që i referohet çmimit minimal për bllok, respektivisht për 80 MHz dhe për 40 Mhz, referuar edhe në Kreun 2, pika (2)/2.1/4/I, varësisht sasisë totale të frekuencave që operatori synon të marrë nga ky proces tenderi. Ju lutem saktësoni nëse kuptimi jonë është i saktë?

Faleminderit,

### **Përgjigje:**

Në përgjigje të pyetjes tuaj, ju konfirmojmë se, vërtetimi bankar do të duhet të plotësohet për shumën që i referohet çmimit minimal për bllok dhe jo mbi bazën e ofertës që do të paraqesë ofertuesi.

Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh se, në dokumentat e tenderit, është parashikuar se një ofertues mund të fitojë deri në 3 (tre) të drejta përdorimi ose deri në 160 MHz sasi spektri. Në këtë kuptim, në rast se ofertuesi do të paraqesë oferta për të gjitha raundet, kriteri do të konsiderohet i përmbushur nga AKEP, nëse vlera e vërtetimit bankar do të jetë të paktën sa vlera minimale e përlogaritur për 160 MHz sasi spektri.